

METODOLOGJIA

E VLERËSIMIT TË RISKUT TË
KORRUPSIONIT NË PROCEDURAT E
PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime dhe Akronimet.....	3
1. Përmbledhje ekzekutive	4
1.1.Të dhëna paraprake.....	4
1.2.Objektivat	5
2. Korniza ligjore në prokurimin publik	6
2.1 Integriteti dhe Konflikti i Interesit në LPP	8
3. Praktikat/modelet ndërkombëtare	10
4. Konteksti i vendit	10
4.1.Të dhënat e mbledhura nga APP	10
4.2.Flamuj të kuq të përdorur nga "Open data".....	11
5. Fazat e prokurimit dhe risqet përkatëse të mundshme për korrupsion në rastin e Shqipërisë.....	12
8.1. Faza e planifikimit.....	13
8.2. Faza e zhvillimit të procedurës së prokurimit	14
8.3. Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës	16
8.4. Faza e ekzekutimit të kontratës	17
6. Metodologjia për Vlerësimin e riskut nga korrupsioni.....	18
10. Qasje e Vlerësimit të Riskut në Nivel Makro.....	18
10. A.1 Mbledhja e të dhënave	18
10.A.2 Treguesit dhe formulat që maten nga APP-ja dhe/ose AK-të.....	20
10.A.3 Analiza e Riskut	23
10.A.4 Masat e zvogëlimit të Riskut	24
10.B Qasje e Vlerësimit të Riskut në Nivel Mikro – Matur nga APP-ja dhe/ose AK-të.....	25
10.B.1 Treguesit dhe Formulatat.....	25
10.B.2 Analiza e Riskut	27
10.B.3 Masat e zvogëlimit të Riskut	28
SHTOJCA 1 – Pyetësor	30

Shkurtime dhe Akronimet

ANAC	Autoriteti Italian për Antikorrupsionin
AK	Autoriteti Kontraktor
KM	Këshilli i Ministrave
OBP	Operatori i Blerjeve të Përqëndruara
FPP	Fjalor i Përbashkët i Prokurimit
OE	Operatori ekonomik
BE	Bashkimi Evropian
SPE	Sistemi i Prokurimit Elektronik
MK	Marrëveshje Kuadër
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
QSH	Qeveria e Shqipërisë
IT	Teknologjia e Informacionit
MEAT	Oferta ekonomikisht më e favorshme
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prania në Shqipëri
NPI	Njoftimi paraprak i informacionit
BNP	Buletini i Njoftimeve Publike
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
DST	Dokumentet Standarde të Tenderit
SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
TI	Transparency International

1. Përmbledhje ekzekutive

1.1. Të dhëna paraprake

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të aktivitetit shtetëror dhe është një nga proceset më të rëndësishme të menaxhimit të financave publike. Sipas raporteve vjetore të publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, fondi total limit i prokuruar në procedurat e prokurimit publik në vitin 2023 përbënte rreth 6.7% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)¹ dhe gjatë vitit 2024 përbënte rreth 16.5%².

Gjithashtu, prokurimi publik një instrument që mund të përdoret për të ndihmuar në arritjen e qëllimeve të tjera të politikave, siç janë qeverisja e mirë, antikorrupsioni, politikat sociale dhe zhvillimi ekonomik. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të ndërtuar një sistem modern për të përmirësuar efektivitetin e përgjithshëm të prokurimit publik, veçanërisht në lidhje me kuadrin ligjor, rregullator dhe institucional, si dhe me zhvillimin dhe funksionimin e një sistemi të prokurimit elektronik.

Ndryshimet e fundit në legjislacionin e prokurimit publik shënojnë një hap tjetër të rëndësishëm drejt përafrimit të legjislacionit shqiptar në këtë fushë me direktivat e BE-së.

Duke qenë një element i rëndësishëm i Sistemit të Menaxhimit Financiar, prokurimi publik është renditur si një fushë me risk të lartë korrupsioni në BE.³ Korrupsioni vlerësohet se i kushton BE-së deri në 990 miliardë euro në vit. Në këtë dokument (Fushat me risk të lartë të korrupsionit në BE: Një hartëzim dhe analizë e thelluar) theksohet se prokurimi publik është ndër aktivitetet më të prirura ndaj korrupsionit të ndërmarrë nga qeveritë. Kjo kryesisht për shkak të vëllimit dhe numrit të madh të transaksioneve që përfshijnë fonde publike; kompleksitetit dhe mungesës së transparencës së procesit; bashkëveprimit tipik të ngushtë midis zyrtarëve publikë dhe bizneseve ofertuese, si dhe numrit të madh të palëve të interesuara të përfshira.

Sipas Raportit të OECD-së mbi “Ryshfetin e Huaj”, 15% e rasteve të ryshfetit të huaj ndodhën në dy sektorë: sektorin nxjerrës dhe atë të ndërtimit, gjë që i bën ata më të prekshmit në këtë drejtim. Prokurimi publik do të ishte një tjetër fushë në të cilën duhet të përqendrohemi; sipas të njëjtit raport, 57% e rasteve të ryshfetit të huaj përfshijnë ryshfete për të marrë kontrata të prokurimit publik.⁴

Meqenëse prokurimi publik është një fushë kaq e ndjeshme ndaj korrupsionit në shtetet anëtare të BE-së, në vende si Shqipëria fokusi në këtë aspekt merr një rëndësi edhe më të madhe.

Në raportin vjetor për Shqipërinë (2024), në Kapitullin 5, përmendet sa vijon:

¹ <https://www.app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/> (faqja 12)

² <https://www.app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/> (faqja 24)

³ <https://op.europa.eu/fr/publication-detail/-/publication/5c0730b2-9769-11ef-a130-01aa75ed71a1/language-en>

⁴ https://read.oecd-ilibrary.org/governance/oecd-foreign-bribery-report_9789264226616-en#page1.

Lidhur me parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik, Shqipëria duhet të përqendrohet në forcimin e mëtejshëm të funksionimit të sistemit të përgjithshëm për të rritur konkurrencën, përputhshmërinë dhe profesionalizimin.⁵ Prandaj, pjesa më e madhe e përpjekjeve mbetet në kuadrin e zbatimit të legjislacionit.

Lufta kundër korrupsionit është një nga çështjet kryesore të ngritura gjatë procesit negociues me Komisionin Europian, i cili kërkon një prezantim të të gjitha masave përkatëse të ndërmarra deri më tani nga Qeveria e Shqipërisë, si dhe angazhimin e institucioneve shqiptare për të ndërmarrë veprime të mëtejshme kundër korrupsionit. Si pjesë e procesit, Shqipëria zhvilloi dhe miratoi disa dokumente që trajtojnë çështjen e korrupsionit dhe prokurimit publik.

Në këtë kontekst, Udhërrëfyeni për Shtetin e së Drejtës⁶, i miratuar nga Qeveria e Shqipërisë nëpërmjet VKM-së 736, datë 13.12.2023⁷ përfshin gjithashtu disa masa të dedikuara për luftën kundër korrupsionit, ndër të cilat miratimi i metodologjisë për identifikimin dhe vlerësimin e rregullësve të riskut të korrupsionit në procedurat e prokurimit publik.

Një objektiv specifik i dedikuar Integritetit në procedurat e prokurimit publik është përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe Planin e Veprimit 2024-2027 të miratuar me VKM Nr. 304, datë 22.5.2024, përkatësisht Objektivi Specifik 3.1. Sigurimi i integritetit në procesin e prokurimit publik, i cili thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstucional midis institucioneve të ndryshme me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe marrjen e masave të duhura që synojnë luftimin e korrupsionit dhe sigurimin e integritetit.

Si pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024–2026, qeveria shqiptare synon të forcojë transparencën, integritetin dhe llogaridhënien në sektorët me risk të lartë, siç janë prokurimi, taksat, doganat, shëndetësia dhe arsimiti. Një komponent kyç i kësaj përpjekjeje është zhvillimi i metodologjive të fuqishme të vlerësimit të riskut të korrupsionit, të bazuara në prova, të përshtatura për sektorin e prokurimit.

1.2. Objektivat

Agjencia e Prokurimit Publik (APP), në partneritet me Autoritetin Italian për AntiKorrupsionin (ANAC) dhe Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Anti Korrupsionin (MAPA), synon të hartojë një metodologji të vlerësimit të riskut të korrupsionit për të identifikuar dhe adresuar risqet përgjatë gjithë ciklit të prokurimit.

Ky proces mbështetet nga prezenca e OSBE në Tiranë si pjesë e Projektit “Forcimi i Kapaciteteve Kundër Korrupsionit dhe Angazhimi i Palëve të Interesuara për Qeverisje

⁵DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT Raporti i vitit 2024 për Shqipërinë, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/commission-staff-working-document-albania_en, (faqja 57)

⁶ <https://www.drejtësia.gov.al/baza-ligjore-dokumente/>

⁷ <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/VKM-nr.-736-date-13.12.2023-P%C3%ABr-miratimin-e-udh%C3%ABr%C3%ABfyesit-p%C3%ABr-shtetin-es%C3%AB-drejt%C3%ABs.pdf>

të Mirë”, i cili, ka si objektiv të përgjithshëm të forcojë kuadrin ligjor dhe institucional për të përmirësuar qeverisjen dhe transparencën, duke parandaluar korrupsionin në përputhje me Strategjinë e re Kombëtare Antikorrupsion 2024 - 2030, të forcojë kapacitetet e institucioneve shtetërore për të luftuar korrupsionin dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi ndikimet e korrupsionit, përmes mbështetjes për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) dhe Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike dhe Anti Korrupsionin (MAPA), për të krijuar një metodologji vlerësimi të riskut të korrupsionit për të identifikuar dhe zvogëluar risqet përgjatë gjithë ciklit të prokurimit.

Objektivi specifik është:

- Hartimi i Metodologjisë së vlerësimit të Riskut të Korrupsionit (MRK) në sektorin e prokurimit publik.

Metodologjia do t'i udhëzojë institucionet publike në identifikimin e fushave të prirura ndaj korrupsionit dhe në zbatimin e masave specifike kundër korrupsionit, duke përfshirë njëkohësisht si kuadrin ligjor kombëtar, ashtu edhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

2. Kuadri ligjor në prokurimin publik

Akti kryesor ligjor që rregullon sistemin e prokurimit publik në Shqipëri është Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 16/2024 (LPP). Rregulla të mëtejshme të detajuara përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021 dhe VKM nr. 498, datë 1.8.2024. Disa VKM kanë vendosur rregulla të tjera në kuadër të sistemit të prokurimit publik.

Përkufizimi në LPP për kontratat publike është: *“Kontratat publike janë kontratat me shpërblim, të lidhura me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj...⁸”*

Baza për të gjitha kontratat dhe procedurat e kryera sipas LPP-së janë parimet e prokurimit publik. LPP-ja u kërkon autoriteteve dhe enteve kontraktore të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë dhe të veprojnë në mënyrë transparente dhe proporcionale. Autoritetet dhe Entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushëveprimin e zbatimit të këtij ligji ose të kufizojnë artificialisht konkurrencën. *Konkurrenca konsiderohet e kufizuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllim favorizimin ose disfavorizimin e padrejtë të operatorëve të caktuar ekonomikë.*

Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.⁹

⁸Neni 4/14 i LPP-së

⁹Neni 3 i LPP-së

Nga ana tjetër, *parimet për rritjen e integritetit në prokurimin publik mbështeten në katër shtylla: transparencë, menaxhim i mirë, parandalim i sjelljes së keqe, llogaridhënie dhe kontroll me qëllim rritjen e integritetit në prokurimin publik. Qëllimi i përgjithshëm është të rriten përpjekjet për integritet në mënyrë që ato të jenë plotësisht pjesë e një menaxhimi efikas dhe efektiv të burimeve publike.*¹⁰

Parimet në prokurimin publik janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe, për sa kohë ato respektohen gjatë procesit të procedurave të prokurimit publik, risku për korrupsion do të jetë i ulët. Metodatat e zakonshme për të zvogëluar riskun e korrupsionit përfshijnë një kuadër ligjor të përshtatshëm, transparencë dhe mbikëqyrje publike, si dhe staf të trajnuar në mënyrë adekuate¹¹.

Mungesa e transparencës në operacionet qeveritare dhe të kompanive mund të jetë një faktor që kontribuon në korrupsion. Fakti që, informacione të caktuara kanë shumë të ngjarë të mos dalin kurrë në dritë – përveçse kur shfaqet ndonjë sinjalizues - mund të jetë një faktor motivues për të vepruar në mënyrë korruptive. Shkurt, korrupsioni lulëzon në errësirë.¹²

Parimi i transparencës është deklaruar qartë në nenet përkatëse që përcaktojnë parimet e LPP-së, neni 3/1.

Parimi i transparencës ka qenë në fokus të politikave në prokurimin publik. Transparenca jo vetëm që është renditur si parim, por gjithashtu janë marrë disa masa për ta garantuar atë, si përdorimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit për çdo procedurë, përdorimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik, publikimi i njoftimeve etj.

Legjislacioni tjetër kombëtar, i cili është relevant, sikundër listuar më poshtë, rregullon të drejtën për informim publik:

- Ligji "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", ligji nr. 33/2022, i përafuar pjesërisht me Direktivën e BE-së 2019/1024 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 qershor 2019¹³;
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";
- Ligji nr. 146/2014 "Për njoftim dhe konsultim publik".

¹⁰Parimet e OECD-së për Integritetin në Prokurimin Publik"https://www.oecd.org/en/publications/oecd-principles-for-integrity-in-public-procurement_9789264056527-en.html(faqja 3)

¹¹"UDHËZUES TEMATIK I PROKURIMIT PUBLIK"<https://knowledgehub.transparency.org/guide/topic-guide-on-public-procurement/4899>(faqja 10)

¹²<https://op.europa.eu/fr/publication-detail/-/publication/5c0730b2-9769-11ef-a130-01aa75ed71a1/language-en>(faqja 123)

¹³Në kuadër të këtij ligji, një opsion i ri është i disponueshëm në faqen e internetit të APP-së që nga viti 2021, duke shfaqur të dhëna mbi procedurat e prokurimit. <https://www.app.gov.al/export-public-calls/> i lidhur me portalin qeveritar të të dhënave të hapura<https://opendata.gov.al/>, ku mund të gjenden edhe të dhënat e prokurimit

2.1 Integriteti dhe Konflikti i Interesit në LPP

Përkufizimi për konfliktin e interesit në legjislacionin shqiptar është: **“Konflikt interesi” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.**¹⁴

LPP-ja i referohet të njëjtit përkufizim edhe në lidhje me konfliktin e interesit në procesin e prokurimit.¹⁵

Ligji i prokurimit publik parashikon integritetin¹⁶si një nga qëllimet e këtij ligji. Në një nen të posaçëm për Mbrojtjen e integritetit të procedurës dhe masat e përgjithshme për të parandaluar korrupsionin parashikohet se: *"Prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial. Procedurat e prokurimit duhet të kërkojnë standardet më të larta të etikës dhe besimit publik. Në çdo rast duhet të shmangët rreptësisht çdo konflikt interesi ose edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e titullarit të autoritetit kontraktor, punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike."*

Punonjësit e autoritetit ose entit kontraktor, të angazhuar në përgatitjen e dokumenteve të tenderit nuk mund të jenë ofertues ose anëtarë në një grup ofertuesish në procedurën e prokurimit.

Autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme në procesin e planifikimit, në procedurën e prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratës, me qëllim zbulimin në kohë të korrupsionit dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të korrupsionit.

Çdo zyrtar i angazhuar në procesin e prokurimit nga autoriteti ose enti kontraktor dhe çdo palë e interesuar që ka informacione për korrupsionin është i detyruar të informojë organet kompetente.

Operatorët ekonomikë me veprimet e tyre nuk duhet të shkelin parimet e konkurrencës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi..¹⁷"

Gjithashtu, pjesë e LPP-së është edhe një nen i dedikuar për konfliktin e interesit, ku përcaktohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi rastet e konfliktit të interesit, që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratës, për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.*

Personat e angazhuar në procesin e prokurimit dhe ekzekutimin e kontratës nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

¹⁴Neni 3 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

¹⁵Neni 4/47 i LPP-së

¹⁶Neni 2/dh i LPP-së

¹⁷Neni 18 i LPP-së

Situata për konfliktin e interesit vlerësohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në kuptim të këtij ligji mbulon çdo situatë ku titullari ose punonjësi të autoritetit ose entit kontraktor ose ofruesit të shërbimit të prokurimit, që vepron në emër të autoritetit ose entit kontraktor, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit, ose mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal, që mund të cenojë paanësinë dhe pavarësinë e tyre në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit.

Autoriteti ose enti kontraktor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në tender nëse:

a) kandidati ose ofertuesi i jep ose premtion t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim ose procedurë që ndërmerr autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit;

b) kandidati ose ofertuesi është në kushtet e konfliktit të interesit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave;

c) kandidati ose ofertuesi në të njëjtën procedurë janë në rrethin e personave të lidhur sipas legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave.

Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë duhet të dokumentohen dhe i komunikohen menjëherë dhe zyrtarisht kandidatit ose ofertuesit në fjalë.

Vendimet e marra nga autoriteti ose enti kontraktor në përputhje me pikën 2 të këtij neni, nuk pengojnë kallëzimin penal në organet përkatëse, kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë veprë penale.

Në rast se gjatë fazës së studimit paraprak të tregut, të përgatitjes së dokumenteve të tenderit ose në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej kandidatëve/ofertuesve ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për studimin e tregut/përgatitjes së dokumenteve të tenderit apo vlerësimin e kërkesave/ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, atëherë titullari i autoritetit kontraktor, në varësi të dëmit që mund të jetë shkaktuar, vendos nëse duhet të zëvendësohen anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit e të vijojë procesin apo të anulojë procedurën e prokurimit.¹⁸

Prej disa vitesh, si pjesë e DST-së, është në fuqi një vetëdeklarim mbi Konfliktin e Interesit që ofertuesit duhet të dorëzojnë në çdo procedurë prokurimi, si dhe vetëdeklarimet e zyrtarëve të prokurimit, anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe njësisë së prokurimit, të cilat duhet të plotësohen prej tyre kur përfshihen në procesin e prokurimit.

Deklarata të tilla dhe një “Manual për parandalimin e konfliktit të interesit në prokurimin publik”¹⁹ janë hartuar në kuadër të një bashkëpunimi të ngushtë midis APP-së dhe

¹⁸Neni 19 i LPP-së

¹⁹ <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5b3f0ecc-d7d9-490a-bfa6-32d8dbfd630b>

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI).

Marrëdhënia midis integritetit dhe korrupsionit është mjaft e fortë. Në disa raporte, u referohet përkufizimeve, risqeve dhe masave të korrupsionit, si dhe risqeve të integritetit.

Me fjalë të tjera, kur korrupsioni është i lartë, integriteti është i ulët dhe anasjelltas.

Një qasje alternative është përdorimi i treguesve të riskut për të identifikuar procedurat e prokurimit potencialisht të korruptuara.²⁰

3. Praktikak/modelet ndërkombëtare

Kjo metodologji u bazua në një përmbledhje të praktikave ndërkombëtare nga BE, OECD dhe ANAC. Praktika të tilla konsiderohen të rëndësishme për kontekstin shqiptar, sepse vendi synon anëtarësimin në BE dhe legjisllacioni i prokurimit është i harmonizuar me Direktivat e BE-së. Në këtë kontekst, të dhënat dhe praktikak e opentender.eu do të zbatohen në vend, duke qenë gjithashtu një referencë e rëndësishme për Shqipërinë. Modeli dhe përvoja e ANAC konsiderohet si një model i mirë në BE, dhe kjo është edhe arsyeja e përvojës së ndarë në këtë fushë midis ANAC dhe institucioneve shqiptare në luftën kundër korrupsionit.

Praktika e OECD-së është një referencë e mirë për Shqipërinë, pasi vendi është anëtar i Qendrës së Zhvillimit, midis 29 vendeve jo-OECD (që nga qershori 2023). Gjithashtu, APP-ja ka një bashkëpunim të ngushtë me SIGMA-OECD.²¹, përmes ndihmës në fushën e prokurimit publik, por edhe përmes vlerësimeve të ndryshme.

4. Konteksti i vendit

4.1. Të dhënat e mbledhura nga APP

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik të Shqipërisë, *APP-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efikasitetit dhe transparencës në procesin e prokurimit publik.*²²

Në këtë kontekst, një nga kompetencat më të rëndësishme të APP-së është hartimi dhe publikimi i një Raporti Vjetor mbi funksionimin e sistemit të prokurimit publik, i cili përfshin edhe statistika dhe të dhëna të rëndësishme në lidhje me procedurat e prokurimit publik.

Të dhënat e përfshira në raportin e APP-së janë:

1. Statistikat mbi procedurat e publikuara të prokurimit;
2. Statistikat mbi njoftimet e fituesit;

²⁰ <https://imonitor.govtransparency.eu/wp-content/uploads/2024/03/D2.2-Risk-assessment-methodology.pdf> (faqja 28)

²¹ Raportet vjetore të APP-së.

²² Neni 22, pika 1, Ligji 162/2020, i ndryshuar

3. Statistikat mbi njoftimet e kontratave të nënshkruara;
4. Statistikat mbi procedurat e anuluarat të prokurimit;
5. Pjesa e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
6. Statistikat rreth Marrëveshjeve Kuadër;
7. Statistikat që lidhen me pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
8. Statistikat rreth përdorimit të kriterëve të vlerësimit 'MEAT' (OFERTA EKONOMIKISHT MË E FAVORSHME BAZUAR NË KOSTO)
9. Statistikat që lidhen me asistencën e ofruar nga APP-ja për AK/EK.;
10. Statistikat që lidhen me verifikimin ex-post të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik;
11. Statistikat që lidhen me zbatimin e kontratave;
12. Statistikat që lidhen me përjashtimin e operatorëve ekonomikë;

Edhe pse të dhënat e publikuara nga APP-ja nuk klasifikohen si tregues të riskut të korrupsionit në raportin vjetor, disa prej tyre mund të përdoren qartë si të tilla.

4.2. Flamuj të kuq të përdorur nga “Open Data”.

Siç u përmend më sipër, rritja e transparencës në prokurimin publik ka qenë një temë thelbësore e theksuar vazhdimisht nga raportet e monitorimit dhe për këtë arsye janë bërë shumë përpjekje për këtë, duke përfshirë shfaqjen e të dhënave mbi procedurat e prokurimit nga viti 2021 si pjesë e portalit të “Open Data”.²³ Në këtë portal renditen edhe disa sinjale paralajmëruese në prokurimin publik.²⁴

Të dhënat mbi procedurat e prokurimit publik mund të filtrohen edhe përmes flamujve të kuq të mëposhtëm dhe shpjegimeve përkatëse:

- ***Mungesa e konkurrencës***

Prokurimi zhvillohet me një konkurrent të vetëm. Ligji shqiptar i lejon procedura të tilla, por ajo që shpesh tregojnë procedura të tilla, më shumë sesa thjeshtë mungesë konkurrence, janë kriteret dhe afatet e aplikimit që janë padyshim në favor të një kompanie të caktuar (klientelizëm). Procedura prokurimi të tilla meritojnë të konsiderohen të ekspozuar ndaj riskut.

- ***Procedura me negociim***

- ***Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës***

²³ <https://www.app.gov.al/export-public-calls/> i lidhur me portalin qeveritar të të dhënave të hapura <https://opendata.gov.al/>, ku mund të gjenden edhe të dhënat e prokurimit.

²⁴ <https://openprocurement.al/en/index/redflag>

- ***Kohë e pamjaftueshme për përgatitjen e ofertave (oferta teknike plus dokumentacioni)***

Afat i pamjaftueshëm sipas kritereve ligjore të përcaktuara në LPP.

- ***Alokimi i fondeve shtesë para përfundimit të fazës së parë të kontratës***

Alokimi i fondeve shtesë para përfundimit të fazës së parë të kontratës. Ekziston gjithashtu një mundësi që autoriteti kontraktor të alokojë një fond shtesë prej 20% të ofertës origjinale. Fonde të tilla duhet të justifikohen nga arsye si vështirësi të papritura të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ndryshime të qarta në treg, ndryshime në indekset e çmimeve, etj.

Rastet e ndarjes së shpejtë të fondeve të tilla shtesë pa justifikim do të konsiderohen si një risk i lartë abuzimi me paratë publike. Vlera shtesë prej 20% nuk i nënshtrohet asnjë konkurrence, por është në diskrecionin e autoritetit/entit kontraktor.

- ***Skualifikimi i të gjithë operatorëve konkurrues përveç fituesit/Skualifikimi i ofertës me vlerën më të ulët***

Autoriteti Kontraktor ka skualifikuar të gjithë operatorët konkurrues me një ofertë më të ulët se oferta fituese. Nuk klasifikohet si skualifikim rasti i operatorit që paraqet dokumente të tjera dhe nuk paraqet asnjë ofertë. Vlerësimi kryhet vetëm për procedurat e prokurimit me vlerë mbi 5 milionë lekë.

- ***Anulimi i procedurës së prokurimit dy ose më shumë herë.***

Në rast të anulimit dy herë të procedurave të prokurimit me të njëjtin objekt, ka vend për të vlerësuar vështirësitë ose faktorët që e kanë bërë të pamundur finalizimin e fituesve të procedurës. Përsëritja dy herë radhazi është një precedent që legjitimon zëvendësimin e konkurrencës së hapur me negociim të drejtpërdrejtë.

5. Fazat e prokurimit dhe risqet përkatëse të mundshme për korrupsion në rastin e Shqipërisë

Risqet e korrupsionit në prokurimin publik mund të lindin në faza të ndryshme të procesit të prokurimit. Çdo fazë paraqet mundësi të ndryshme për praktika korruptive, duke filluar nga ryshfeti dhe shpërblimet deri te mashtrimi dhe përvetësimi i paligjshëm i fondeve.

Megjithatë, korrupsioni është i vështirë për t'u zbuluar për shkak të kompleksitetit të procedurave të përfshira, të cilat shpesh kërkojnë një nivel të lartë ekspertize teknike në të gjitha fazat e procesit.

Faza e përzgjedhjes së projektit

Në fazën e përzgjedhjes së projektit, vlerësimet e nevojave mund të manipulohen, të fryhen ose të nxiten artificialisht për të zgjedhur projekte me vlerë më të lartë të kontratës. Projektet gjithashtu mund të identifikohen për t'i shërbyer interesave të ofertuesve të veçantë ose interesave private të zyrtarëve të prokurimit. Në raste të tilla, bashkëpunimi dhe/ose korrupsioni politik mund të ndikojnë në prokurimin publik.

Procesi i ofertimit

Gjatë fazës së procedurës së prokurimit publik, mundësitë për korrupsion janë të shumta. Ndërsa supozohet përgjithësisht se risqet e korrupsionit janë veçanërisht të larta gjatë vlerësimit të ofertave, faza e specifikimit mund të hartohet për të kufizuar konkurrencën dhe për të favorizuar ofertues të veçantë. Disa ofertuesve mund t'u jepet një avantazh i padrejtë (për shembull, qasje ekskluzive në informacion) si rezultat i faktit që zyrtarët kanë një interes privat në këto kompani, ose në këmbim të një ryshfeti. Një zyrtar qeveritar mund të kërkojë një ryshfet ose një shpërblim në këmbim të dhënies së një kontrate, dhe ryshfetedhënësi mund ta fryjë çmimin e kontratës për të mbuluar ryshfetin dhe për të ruajtur fitimet e tij. Ofertuesit gjithashtu mund të komplotojnë për të rregulluar rezultatin e një oferte dhe për të fryrë çmimet e kontratave të cilat më pas ndahen midis kompanive, ndonjëherë me bashkëpunimin e zyrtarit të prokurimit, të cilit mund t'i ofrohet një shpërblim për mbylljen e një syri ndaj praktikave të tilla. Zyrtarët e prokurimit ose miqtë dhe të afërmit e tij/saj mund të kenë gjithashtu një interes ekonomik në njërën nga kompanitë ofertuese. Praktika të tjera korruptive mund të përfshijnë abuzimin me konfidencialitetin, kufizimin e reklamës dhe publicitetit, dhe manipulimin e dorëzimit dhe vlerësimit të ofertave.

Zbatimi i kontratës

Ndërkohë që shpesh i kushtohet më pak vëmendje zbatimit të kontratës, ka shumë mundësi për abuzim në këtë fazë të procesit, duke përfshirë faturimin e rremë, mbifaturimin, nën-performancën dhe mospërbushjen e standardeve të specifikimeve, ndër të tjera. Zakonisht në këtë fazë të procesit pagesat korruptive të bëra në fazat e mëparshme të procesit mund të rikuperohen me anë të kryerjes së shërbimeve më pak se ato të rëna dakord në kontratë, ose duke ndryshuar kontratën përmes rinegociimeve të njëpasnjëshme.

Më poshtë janë treguesit e zakonshëm të risqeve të korrupsionit për çdo fazë të ciklit të prokurimit, të sugjeruar si një grup treguesish për rastin e Shqipërisë, bazuar në praktikën ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në prokurimin publik. Ky është gjithashtu një shpjegim se si situata të caktuara janë potencialisht të ekspozuara ndaj korrupsionit dhe si të kuptohen treguesit që duhen matur përmes kësaj metodologjie.

5.1. Faza e planifikimit

a) Publikimi i tenderit:

- **Numri i Procedurave të Prokurimit të Publikuara**

Një numër i lartë i procedurave mund të tregojë një mjedis të shëndetshëm prokurimi. Një rënie e papritur e tyre mund të sinjalizojë probleme si manipulimi i tregut ose mungesa e planifikimit të prokurimit.²⁵

- **Numri i Procedurave të Prokurimit të Publikuara sipas afatit të planifikuar**

Autoritetet kontraktore miratojnë dhe publikojnë planet e prokurimit. Vonesa në publikimin e procedurës së prokurimit mund të tregojë një risk të praktikave korruptive (AK-të përpiqen të bien dakord me ofertuesin potencial fitues mbi

²⁵Nëse në vendet e BE-së prokurimi publik përbën rreth 14% të produktit të brendshëm bruto (PBB) të BE-së, në Shqipëri fondi limit total i prokuruar në vitin 2023 përbënte rreth 6.7% të PBB-së.

kriteret e kualifikimit, kushtet e kontratës, sasitë, etj.), identifikim fiktiv të nevojave dhe prioriteteve të prokurimit.

- **Numri i Procedurave të Prokurimit të publikuara sipas përlllogaritjes fillestare të çmimit** Vlera e parashikuar e kontratës mund të ndryshojë për arsye jo-objektive. Përfitimet dhe/ose fitimet ekskluzive të kompanisë në vend të përmbushjes së nevojave kolektive, për shembull me vlera të nënvlerësuar dhe/ose të pasakta të kontratave, mund të çojnë në modifikime/variante me kosto më të larta si pasojë. Një situatë e tillë mund të përbëjë një risk për praktika korruptive.

- **Numri i Procedurave të Prokurimit të publikuara ku parashikohet një afat më i shkurtër për dorëzimin e ofertës:**

Edhe pse LPP-ja e parashikon këtë mundësi, ajo parashikohet si përjashtim nga ligji, por ka situata kur AK-të e përdorin këtë mundësi dhe, nga ana tjetër, e zgjasin periudhën e vlerësimit përtej afatit ligjor. Kjo krijon hapësirë për korrupsion dhe favorizim, duke shmangur pjesëmarrjen e kompanive që nuk mund të paraqesin ofertën e tyre në një afat kaq të shkurtër.

- **Lloji i procedurës së përzgjedhur, procedurë prokurimi e hapur kundrejt procedurës së kufizuar dhe jo vetëm:**

LPP-ja parashikon lloje të ndryshme procedurash që mund të përdoren nga AK-të dhe situata përkatëse që duhen përdorur. Edhe pse nuk ka preferencë midis procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar, përdorimi i procedurës së hapur garanton më shumë transparencë, të paktën në kontekstin e vendit. Procedura e kufizuar ndonjëherë përdoret për të skualifikuar lehtësisht ofertuesit, pasi ende nuk ka një ofertë ekonomike.

b) Qartësia e Specifikimeve të tenderit:

- **Përqindja e Specifikimeve të tenderit me Kriteria të Qarta dhe Transparente:**

Procedurat e prokurimit me kërkesa të paqarta ose tepër specifike që kufizojnë konkurrencën riskojnë të favorizojnë ofertues të caktuar. Ndonjëherë kriteret e hapura mund të nxisin konkurrencën, por nga ana tjetër mund të keqpërdoren nga autoritetet kontraktore për t'ua dhënë kontratën ofertuesve të pakualifikuar. Ose kriteret e paqarta mund të përdoren nga AK-të për të skualifikuar ofertuesit.

- **Numri i ankesave në lidhje me specifikimet e tenderit, kriteret e kualifikimit dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

Ankesat e shpeshta nga operatorët ekonomikë në lidhje me drejtësinë ose qartësinë e procedurës së prokurimit mund të sugjerojnë një risk për praktika korruptive, të tilla si manipulimi i ofertave.

- **Përqindja e ofertës që përdor kriteret “MEAT” kundrejt çmimit më të ulët:**

Kjo mund të konsiderohet si një tregues i performancës dhe jo si një tregues i riskut të korrupsionit, por mund të krijojë hapësirë për mashtrim dhe korrupsion në disa raste (ndonjëherë AK-të përdorin çmimin më të ulët si kriter për të shmangur kostot shtesë për ofertuesin fitues, siç është mirëmbajtja, dhe preferojnë të sigurojnë mirëmbajtje veçmas, gjë që përgjithësisht rezulton në procedurë me një ofertues të vetëm, etj.).

5.2. Faza e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

a) Pjesëmarrja në procedurën e prokurimit:

- **Shkalla e Pjesëmarrjes në Procedurën e prokurimit;** Raporti i procedurave të publikuara ndaj ofertave aktuale të dorëzuara. Një rënie e ndjeshme mund të tregojë se kushtet e procedurës së prokurimit mund të jenë të padrejta ose kufizuese. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes mund të jenë një flamur i kuq për manipulim ofertash ose kushte kufizuese që përjashtojnë furnizues të caktuar. Ekziston një numër i konsiderueshëm procedurash prokurimi ku paraqitet vetëm një ofertë dhe gjithashtu një numër i konsiderueshëm procedurash ku janë paraqitur disa operatorë ekonomikë pa paraqitur një ofertë ekonomike, duke qenë ky një flamur i kuq edhe për marrëveshje në oferta.
- **Numri i ofertave të skualifikuara në krahasim me numrin e ofertave të dorëzuara:**
Është plotësisht e ligjshme të skualifikohet një operator ekonomik nëse nuk përmbush kriteret e procedurës së prokurimit, por gjithashtu mund të jetë një sinjal alarmi nëse skualifikimi nuk është i justifikuar, ose, nëse për të njëjtën arsye, në të njëjtën procedurë ose i njëjti AK në procedura të tjera i ka kualifikuar ofertuesit. Ndonjëherë skualifikime të tilla përdoren për të favorizuar ofertuesin e zgjedhur.
- **Shkalla e tërheqjes vullnetare (tërheqja e ofertuesve) në fazat e para-përzgjedhjes dhe përzgjedhjes:**
Një tërheqje vullnetare mund të tregojë një marrëveshje të paligjshme midis ofertuesve ose veprime të AK-së që kanë ndikuar në këtë vendim.

b) Procesi i Vlerësimit të Ofertave:

- **Shkalla e Refuzimit të Ofertave**
Përqindja e ofertave të refuzuara krahasuar me ato të dorëzuara. Një shkallë e lartë refuzimi pa arsye transparente dhe të justifikuar mund të sinjalizojë favorizim ose manipulim.
- **Mospërputhjet në pikëzim**
Gjurmoni numrin e rasteve ku vlerësimi i ofertave ndryshon ndjeshëm nga kriteret objektive të vlerësimit. Kjo mund të tregojë vlerësim subjektiv dhe/ose manipulim.
- **Koha Mesatare për Vlerësimin e Ofertave**
Vonesat në vlerësimin e ofertave mund të sugjerojnë manipulim të mundshëm dhe/ose një përpjekje për të ndryshuar rezultatet, dhe/ose për të kontaktuar pjesëmarrësit për të ndikuar në vendime të mëtejshme. Një vonesë e tillë mund të vlerësohet edhe në rast të një vendimi të KPP-së (një vendim i KPP-së përtej afatit dhe/ose kur AK-të tejkalojnë 5 ditët për të marrë një vendim të ri bazuar në vendimin e KPP-së, të parashikuara nga rregullat në fuqi).

b) Pajtueshmëria me Kriteret e Vlerësimit:

- **Përqindja e ofertave që përmbushin të gjitha kriteret e vlerësimit:**
Ofertat duhet të vlerësohen bazuar në kriteret e paracaktuara dhe transparente. Një numër i lartë devijimesh mund të tregojë trajtim preferencial për furnizues të caktuar. Numri i ulët i ofertave që plotësojnë të gjitha kriteret e vlerësimit mund të tregojë trajtim preferencial kur kriteret janë hartuar.
- **Numri i vendimeve të dhënies së procedurave të prokurimit të ndryshuara**

Nëse vendimet e dhënies së procedurave të prokurimit përmbysen ose ndryshohen/ankimohen shpesh, kjo mund të sinjalizojë një vlerësim të gabuar ose hapësirë për korrupsion.

c) Transparenca e Vendimeve të fituesve:

- **Përqindja e Kontratave për të cilat vendimi i fituesit është publikuar pa argumentimin përkatës.**

Transparenca është thelbësore në uljen e riskut të korrupsionit. Mungesa e justifikimit për dhënien e kontratave dhe/ose mungesa e argumenteve për skualifikim (arsye të tilla si mungesa e dokumenteve, pa specifikuar se çfarë lloj dokumenti, në lidhje me cilat kritere nuk janë plotësuar) mund të sinjalizojë se procesi është manipuluar.

- **Numri i vendimeve të fituesve të shqyrtuara/ankimuar**

Nëse një numër i madh i vendimeve të fituesve kundërshtohen ose rishikohen, kjo mund të sinjalizojë probleme sistemike në procesin e prokurimit, të tilla si paragjykimi ose kritere të papërshtatshme përzgjedhjeje.

- **Numri i procedurave ku OE skualifikohen dhe kontrata i jepet të njëjtit OE si vitin e kaluar**

Ndonjëherë bëhet skualifikimi me qëllim që kontrata t'i jepet të njëjtit ofertues me të cilin AK ka lidhur kontrata në vitet e fundit.

- **Numri i procedurave ku oferta anomalisht e ulët është skualifikuar automatikisht**

Mund të ketë situata ku dy ose më shumë OE mund të bien dakord për ofertën e tyre ekonomike, në mënyrë që ofertat e tjera të jenë anomalisht të ulëta. Edhe pse një rregull i tillë zbatohet vetëm për procedurat e prokurimit nën kufi, meqenëse shpenzohen më shumë fonde në këtë kufi sipas raporteve vjetore të APP-së, është e rëndësishme të theksohet se situata të tilla nuk keqpërdoren për arsye fitimi të paligjshëm.

- **Diferenca midis vlerës së parashikuar të kontratës dhe vlerës së fituar:**

Ndonjëherë ndryshimet e mëdha midis vlerës së parashikuar të kontratës dhe vlerës së fituar, nënkuptojnë një planifikim të dobët nga AK-ja, por gjithashtu mund të jetë që vlera e parashikuar të jetë "planifikuar" për fituesin e preferuar, ose AK-ja, në konsultim me ofertuesin fitues, bien dakord të përmirësojnë më tej vlerën e kontratës përmes ndryshimeve të kontratës. Ndryshime të vogla, ose edhe mungesa e asnjë ndryshimi, mund të jenë një sinjal se nuk ka pasur konkurrencë të vërtetë gjatë procesit të procedurës së prokurimit. 58.3. *Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës*

- **Koha e Nevojshme për të Nënshkruar Kontratat**

Një vonesë e konsiderueshme në nënshkrimin e kontratës pas dhënies së saj mund të tregojë probleme, të tilla si nevoja për negociata shtesë ose pagesa shtesë.

- **Kontrata e nënshkruar pa respektuar periudhën e pritjes**

Kur autoritetet kontraktore "nxitohen" për të nënshkruar një kontratë, shmangia e ankesave të operatorëve ekonomikë mund të ofrojë informacion mbi korrupsionin ose paragjykimet e mundshme.

- **Përqindja e Kontratave të Dhëna ndaj Furnizuesve të Rinj ose të Diversifikuar**

Mungesa e diversitetit në kontratat e dhëna mund të tregojë favorizim ndaj një grupi të vogël furnizuesish, ndoshta për shkak të korrupsionit ose marrëveshjes së fshehtë.

5.4. Faza e ekzekutimit të kontratës

a) Zbatimi dhe Dorëzimi i Kontratës:

- **Përqindja e Kontratave të Dorëzuara në Kohë dhe Brenda Buxhetit**

Një shkallë e lartë vonesash ose tejkalimesh të kostove mund të sugjerojë keqmenaxhim ose mashtrim. Anasjelltas, dorëzimet vazhdimisht në kohë dhe nën buxhet mund të jenë një shenjë favorizimi ose mungese transparence në proces. (p.sh. Ndonjëherë AK-të publikojnë afate të shkurtra për zbatimin e kontratës, duke qenë kjo një arsye që ofertuesi tjetër të mos paraqesë një ofertë, por në fund afati zgjatet, duke qenë ky një sinjal paralajmërues se një palë e caktuar po përfiton.)

- **Përqindja e Kontratave të Finalizuara pa Modifikime**

Modifikimet e shpeshta ose të pajustificuara të kontratave pas dhënies së kontratës mund të jenë një sinjal paralajmërues për marrëveshje të papërshtatshme ose përpjekje për të ndryshuar kushtet nën tavolinë. Ndryshimet e tepërta ose të pajustificuara të kontratave pas dhënies së kontratës mund të sinjalizojnë përpjekje për të rritur kostot ose për të modifikuar kushtet në dobi të palëve të caktuara.

b) Monitorimi dhe Mbikëqyrja:

- **Përqindja e Kontratave nën Monitorim Aktiv**

Duhet të jenë në vend mekanizma monitorimi për të ndjekur performancën e kontratës. Një përqindje e ulët e kontratave të monitoruara mund të rrisë riskun e korrupsionit. Në legjislacionin e prokurimit publik është vendosur që AK-të duhet të emërojnë një person/grup personash për të ndjekur ekzekutimin e kontratës, duke shmangur këtë, pasi është një sinjal se kontrata mund të mos ekzekutohet sipas termave të referencës dhe kriterëve e kushteve të tjera të publikuara.

- **Frekuenca e Auditimeve të Kontratës**

Auditimet e rregullta të kontratave aktive ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë dhe parandalimin e shpërdorimit të fondeve. Mungesa e auditimeve rrit riskun e mashtrimit ose ryshfetit. Shumica e AK-ve kanë auditimin e tyre të brendshëm, disa kontrata auditohen edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ose APP.

c) Afati kohor dhe pajtueshmëria e pagesave:

- **Përqindja e pagesave të bëra në kohë**

Vonesat në pagesa mund të sugjerojnë praninë e ryshfeteve ose formave të tjera të korrupsionit, ku fondet vonohen për të nxjerrë ryshfete.

- **Numri i mospërputhjeve në pagesa**

Gjurmimi i rasteve të pagesës së tepërt ose ndryshimeve të pajustificuara në orarin e rënë dakord të pagesave. Mospërputhjet e shpeshta mund të sinjalizojnë korrupsion ose mashtrim, si dhe favorizim.

b) Produktet Përfundimtare kundrejt Kushteve të Kontratuara:

- **Përqindja e Kontratave me Produkte të Dorëzuara që Përputhen me Specifikimet**

Nëse rezultatet e dorëzimit nuk përputhen me specifikimet e kontratës, kjo mund të jetë tregues i punës nën standard ose mashtrimin.

Në kontratat e punës

- **Përqindja e kontratave ku për të njëjtin ofertues të dhënë mbikëqyrësi është i njëjtë:**

Ekzistojnë disa situata kur mbikëqyrësi për të njëjtin kontraktor është i njëjti në kontrata të ndryshme, pavarësisht faktit se mbikëqyrësi zgjidhet përmes një procedure prokurimi. Janë bërë shumë përpjekje përmes legjislacionit të prokurimit publik për të shmangur që operatorët ekonomikë që nuk i plotësojnë kriteret ose nuk kanë kapacitetet minimale të mos mund të kualifikohen. Por duket se ka sinjale të forta se në fazën e zbatimit, edhe një numër i caktuar punonjësish, makinerish, automjetesh etj., kërkohen përmes Dokumenteve të Tenderit, të cilat nuk janë të disponueshme në vend, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e kontratës, duke qenë një sinjal i fortë mashtrimi dhe korrupsioni.

6. METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E RISKUT TË KORRUPSIONIT

Ky dokument ofron një qasje me metoda të përziera që kombinon analizën e të dhënave të gjeneruara nga sistemi i prokurimit elektronik dhe pyetësorët e shpërndarë autoriteteve kontraktore/zyrtarëve të prokurimit për të vlerësuar risqet dhe praktikatat e korrupsionit brenda sistemit të prokurimit publik të Shqipërisë.

Kjo metodologji përshkruan dy nivele të Qasjes së Vlerësimit të Riskut:

- A. Qasja e Vlerësimit të Riskut në Nivel Makro** (në përgjithësi, APP kryen vlerësimin e riskut për të gjitha autoritetet kontraktore dhe të gjitha procedurat e prokurimit).
- B. Qasja e Vlerësimit të Riskut në Nivel Mikro** (APP kryen vlerësimin e riskut vetëm për disa sektorë ose disa autoritete kontraktore dhe/ose autoritetet kontraktore mund të kryejnë një vlerësim të tillë për një ose më shumë procedura, ose për sektorë specifikë brenda autoritetit kontraktor).

Metodologjia për vlerësimin e riskut të korrupsionit në prokurimin publik, si për nivelin makro ashtu edhe për atë mikro, është e strukturuar në tre komponentë kryesorë:

- 1. Mbledhja e të dhënave**
- 2. Analiza e riskut të korrupsionit**
- 3. Strategjitë/veprimet për zvogëlimin e riskut.**

10. Qasje e Vlerësimit të Riskut në Nivel Makro

10. A.1 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave për vlerësimin e riskut si në nivel makro ashtu edhe në atë mikro do t'i referohet të gjitha të dhënave të disponueshme për prokurimin publik në vend.

Mbledhja e të dhënave do të bëhet përmes:

- Të dhënave në SPE
- Pyetësorëve
- Të dhënave në dispozicion të autoriteteve kontraktore (anketa të tregut, amendimet e kontratave, etj.)
 - Të dhënat e SPE

Të dhënat nga SPE do të jenë të dhënat kryesore për t'u referuar për APP-në, pasi të gjitha informacionet e futura në SPE pasqyrojnë të dhëna për të gjitha procedurat e prokurimit të kryera nga të gjitha autoritetet kontraktore.

Të njëjtat të dhëna mbeten bazë edhe për vlerësimin e riskut në nivel mikro si për autoritetet kontraktore ashtu edhe për APP-në.

Meqenëse pritet të vendoset një sistem i ri elektronik, nëpërmjet tij mund të merren më shumë të dhëna mbi procedurat e prokurimit dhe të përmirësohet cilësia e vlerësimit të riskut të korrupsionit.

➤ *Pyetësorë*

Duke marrë parasysh treguesit, por edhe duke analizuar të dhënat e prokurimit kryesisht përmes SPE-së, APP-ja mund të zgjedhë gjithashtu të kryejë anketa për të gjitha ose për një numër të caktuar autoritetesh kontraktore.

APP-ja mund t'u kërkojë autoriteteve kontraktore të plotësojnë pyetësorin periodikisht ose rast pas rasti.

Kritere të tilla si shuma totale e buxhetit të prokuruar, numri i procedurave, numri/vlera e procedurave më pak konkurruese të zhvilluara, numri i procedurave me një ofertues të vetëm, etj., mund të jenë tregues që APP-ja të iniciojë dërgimin e pyetësorit.

Kur numri dhe/ose vlera duhet të përfundohet në përqindje, ajo do të llogaritet bazuar në numrin/vlerën totale të procedurave mbi kufirin për blerjet e vogla të kryera për autoritetin kontraktor në periudhën e referuar.

Pyetësori mund të kryhet vetëm për disa sektorë, siç janë punët publike, shëndetësia, etj., ku numri dhe vlera e prokuruar është më e lartë.

Anketa mund të përqendrohet edhe në disa institucione në varësi të llojit të tyre, për shembull bashkitë (institucionet e qeverisjes vendore), organet e blerjes së përqendruar (siç janë institucionet e krijuara për këtë qëllim, ose autoritetet kontraktore që prokurojnë për institucionet e tyre të varësisë).

APP-ja mund ta kryejë këtë anketë në mënyrë të pavarur ose si plotësuese të vlerësimit të riskut përmes analizës së treguesve që do të maten nga APP-ja nga të dhënat e SPE-së, si në vlerësimin makro ashtu edhe në atë mikro.

Autoritetet kontraktore mund ta kryejnë këtë anketë si vetëvlerësim në çdo kohë, me qëllim përmirësimin e praktikave të tyre të brendshme.

Pyetjet në anketë mund të modifikohen/përshtaten sipas nevojave të APP-së apo vete autoriteve kontraktore.

Pyetje të tilla mund të lidhen në mënyrë strikte me treguesit e matur nga APP-ja, ose plotësuese, në mënyrë që APP-ja t'i analizojë thellësisht treguesit.

Për shembull: nëse një nga treguesit që do të matet është "Numri i procedurave të anuluar", mund të bëhen pyetje plotësuese për të identifikuar arsyet pas kësaj (specifikat e tregut; ligje/licenca të tjera; gabime në dokumentet e tenderit).

Pyetëtori mund të përdoret si një mjet për të matur treguesit, por edhe për të adresuar më tej strategjitë dhe/ose veprimet për zvogelimin e riskut për të përmirësuar tregues të tillë në të ardhmen.

Një listë me pyetje të sugjeruara është në dispozicion në Shtojcën 1 – Pyetësor.

10.A.2 Treguesit dhe formulat që duhen matur nga APP-ja dhe/ose AK-të

Metodologjia përfshin tregues të riskut të korrupsionit dhe formula matëse të përafruara me praktikën më të mira të Autoritetit Kombëtar Italian Kundër Korrupsionit (ANAC), të përshtatura për kontekstin Shqiptar.

Nr.	Treguesi	Formula	Nivelet e Riskut	Frekuenca e matjes	Niveli i matjes
1	Përdorimi i MEAT (Oferta më ekonomikisht më e favorshme) bazuar në kosto	$(\text{Vlera totale e dhënë për procedurat që përdorin MEAT bazuar në kosto} / \text{Vlera totale e procedurave të përfunduara me një fitues}) \times 100$	E ulët ($\geq 80\%$), E moderuar (40–80%), E lartë ($\leq 40\%$)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial
2	Pjesa e Procedurave me Negocim pa Shpallje paraprake	$(\text{Numri i Procedurave me Negocim} / \text{Numri total i Procedurave të Përfunduara me një fitues}) \times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial

Nr.	Treguesi	Formula	Nivelet e Riskut	Frekuenca e matjes	Niveli i matjes
3	Vlera e Procedurave me Negocim pa Shpallje Paraprake	(Vlera e Kontratave me Negocim / Vlera Totale e Procedurave të Përfunduara me një fitues) × 100	E ulët (≤10%), E moderuar (10–40%), E lartë (≥40%)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial
4	Numri i procedurave të anuluar	(Numri i procedurave të anuluar/numri total i procedurave të prokurimit të publikuara) × 100	E ulët (≤10%), E moderuar (10–40%), E lartë (≥40%)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial
5	Vlera e procedurave të anuluar	(Vlera e procedurave të anuluar/fondi limit total i procedurave të prokurimit të publikuara) × 100	E ulët (≤10%), E moderuar (10–40%), E lartë (≥40%)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial
6	Procedurat me një ofertë të vetme	(Numri i procedurave me një ofertë të vetme të finalizuara me fituesin / Numri total i procedurave të prokurimit të publikuara) × 100	E ulët (≤5%), E moderuar (5–20%), E lartë (≥20%)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial
7	Vlera e Kontratave me një Ofertë të Vetme	(Vlera e procedurave me një ofertë të vetme të finalizuara me fituesin / Vlera totale e procedurave të prokurimit të publikuara) × 100	E ulët (≤5%), E moderuar (5–20%), E lartë (≥20%)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial

Nr.	Treguesi	Formula	Nivelet e Riskut	Frekuenca e matjes	Niveli i matjes
8	Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë	(Numri total i ofertave të dorëzuara/numri total i procedurave të prokurimit të publikuara)	E ulët (≥ 10), E moderuar (3-10), E lartë (≤ 2)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial
9	Dominimi i Furnizuesve	(numri i procedurave të prokurimit të dhëna të njëjtit Furnizues / Numri total i procedurave të përfunduara me një fitues) $\times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial
10	Modifikimet e Kontratës	(Numri i Kontratave të Modifikuara / Totali i Kontratave) $\times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore	-Kombëtar -Administrata vendore, -Autoriteti Kontraktor -lloji i kontratës (punë, shërbime, furnizime) -sektorial

Në total, rekomandohen 10 tregues që duhen matur në periudhën afatshkurtër. Matja e treguesve do të bëhet çdo vit për të gjitha procedurat e prokurimit mbi kufirin e prokurimit me vlerë të vogël në nivel kombëtar.

Duke pasur parasysh që çdo vit, gjatë periudhës Mars-Prill, APP publikon një raport vjetor mbi prokurimin publik në vend, vlerësimi i riskut të korrupsionit mund të bëhet edhe gjatë gjysmës së parë të vitit dhe të publikohet deri në qershor të çdo viti.

Në varësi të të dhënave të marra në nivel kombëtar, APP-ja mund të ndërmarrë veprime të mtejshme për të detajuar më tej analizën mbi të gjithë ose disa nga treguesit duke e zgjeruar matjen tek autoritetet kontraktore individuale, niveli i qeverisjes vendore, lloji i kontratave (Punë, shërbime, furnizime) ose sektorë specifikë. Kjo mund të bëhet edhe duke përdorur pyetësin sipas Shtojcës 1.

10.A.3 Analiza e riskut

Bazuar në vlerësimin e të dhënave si më sipër, secilit tregues do t'i caktohet një pikëzim, duke përcaktuar nivelin e përgjithshëm të riskut për secilin prej tyre dhe duke përcaktuar flamujt e kuq.

Niveli i riskut duhet të vizualizohet në një skemë ngjyrash si më poshtë.

- “I ulët” → Jeshile
- “I moderuar” → E verdhë
- “I lartë” → E kuqe

Nëse për çdo nivel të matur, për secilin tregues, rezultati i Ulët caktohet 1 pikë; i Mesëm - 2; dhe i Lartë - 3, me numrin total të treguesve që është 10, tabela më poshtë mund të tregojë situatën e përgjithshme:

Treguesi	Nivel i ulët risiku $X \leq 10$	Nivel i moderuar risiku $10 < X \leq 20$	Nivel i lartë risiku $20 < X \leq 30$	X = Numri i pikëve totale për të gjithë treguesit
1	1	2	3	
2	1	2	3	
3	1	2	3	
4	1	2	3	
5	1	2	3	
6	1	2	3	
7	1	2	3	
8	1	2	3	
9	1	2	3	
10	1	2	3	
Totali	10	20	30	X

Në varësi të vlerës së pikëve për secilin tregues, rezultati total mund të jetë një kombinim i tre kolonave. Sa më i lartë të jetë rezultati, aq më i lartë është edhe risku i korrupsionit.

Për shembull,

Treguesi	Nivel i ulët risiku $X \leq 10$	Nivel i moderuar risiku $10 < X \leq 20$	Nivel i lartë risiku $20 < X \leq 30$	X = Numri i pikëve totale për të gjithë treguesit
1	1			1
2			3	3
3			3	3
4	1			1
5	1			1
6		2		2
7			3	3
8		2		2
9			3	3
10			3	3
Totali	3	4	15	22

Rezultati total në këtë rast është $3 + 4 + 15 = 22$ pikë, pra $X = 22$, duke e klasifikuar në nivelin e tretë, nivel të lartë risku.

Përmes këtij vlerësimi dhe duke përdorur edhe pyetësorët dhe vlerësimin e riskut në nivel mikro, APP-ja mund të identifikojë masat që duhen ndërmarrë, për të ulur më tej vlerën e treguesve.

10.A.4 Masat e zvogëlimit të Riskut

Masat pasuese duhet të merren në konsideratë nga APP-ja kur kryen një vlerësim të riskut të korrupsionit, i cili mund të përcaktohet si më poshtë.

- **Risk i Ulët: Ruani praktikat aktuale dhe vazhdoni monitorimin.**
- **Risk i Moderuar: Zbatoni veprime korigjuese dhe përmirësoni mbikëqyrjen.**

Veprimet specifike korigjuese do të përcaktohen duke marrë parasysh treguesin specifik, llojin e kontratës ku është identifikuar ky nivel risku, sektorin të cilit i referohet Autoritetit Kontraktor specifik (nëse është ky rasti), varësisht nga niveli i ndarjes së përdorur për vlerësimin e treguesit të dhënë.

APP-ja mund të komunikojë me autoritetet kontraktore për veprime të mëtejshme nga ana e tyre, si dhe mund të nxjerrë rekomandime përkatëse se si të adresohet ose parandalohet risku në të ardhmen.

- **Risk i Lartë: Kryerja e monitorimit të thelluar të procedurave ose kontratave të prokurimit nga APP-ja dhe zbatimi i gjobave..**

Në rast se identifikohet një nivel i lartë risku korrupsioni në fusha/sectorë të caktuar ose autoritete kontraktore, APP-ja mund të vendosë të vazhdojë më tej me monitorimin ex-post të procedurave të prokurimit ose monitorimin e ekzekutimit të kontratës dhe të vendosë penaltete për shkeljet përkatëse.

Një kombinim i masave të lartpërmendura me procesin e profesionalizimit në prokurimin publik do të vlerësohet rast pas rasti.

10.B Qasja e Vlerësimit të Riskut në Nivel Mikro – Matur nga AK-të dhe/ose APP

Vlerësimi i riskut të korrupsionit në nivel mikro përqendrohet në identifikimin e dobësive specifike në nivelin e autoritetit kontraktor (AK) dhe procedurës së prokurimit. Kjo përfshin boshllëqet procedurale, treguesit e sjelljes dhe dobësitë operacionale që mund t'i ekspozojnë proceset e prokurimit publik ndaj korrupsionit.

Vlerësimi i riskut të korrupsionit në nivel mikro synon të zbulojë praktikën e prirura ndaj korrupsionit në nivelin e autoriteteve individuale kontraktore, duke mundësuar analizën krahasuese dhe analizën e trendit me kalimin e kohës, në mënyrë që të garantojë masa të synuara parandaluese ose zbutëse.

Vlerësimet në nivel mikro mund të zgjerohen tek autoritetet individuale kontraktore, procedurat specifike të prokurimit, veçanërisht ato mbi kufirin e lartë ose sektorë specifikë si Shëndetësia, Arsimi, Infrastruktura, etj.

Në këtë rast do të zbatohet e njëjta mbledhje e të dhënave siç përshkruhet në pikën 10.A.1 më sipër.

10.B.1 Treguesit dhe Formulat

Siç parashikohet në seksionin e mësipërm, të gjithë treguesit e parashikuar në atë seksion që do të maten nga APP-ja mund të përdoren gjithashtu për të kryer një vlerësim të riskut në nivel mikro. Përveç kësaj, tregues të tjerë plotësues mund të përdoren për vlerësimin e riskut në nivelin e AK-së, si dhe sipas procedurave specifike të prokurimit si më poshtë:

Nr.	Treguesi	Formula	Nivelet e Riskut	Frekuenca e matjes
1	Procedurat publikohen me vonesë krahasuar me regjistrin e parashikimeve	(Numri i procedurave të publikuara përtej periudhës së planifikuar/Totali i procedurave të planifikuara) x 100	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore

Nr.	Treguesi	Formula	Nivelet e Riskut	Frekuenca e matjes
2	Numri i procedurave të publikuara më shumë se një herë (procedurat e anuluar dhe të rishpallura)	$(\text{Numri i procedurave të rishpallura} / \text{Totali i procedurave të publikuara}) \times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore
3	Kohëzgjatja e periudhës së publikimit	Numri i ditëve midis publikimit të procedurës së prokurimit dhe afatit të fundit të dorëzimit	E ulët (≥ 15 ditë), e moderuar (7-15 ditë), e lartë (≤ 7 ditë)	Çdo vit/për procedurë specifike
4	Çmimi i ofertuesit të vetëm	$(\text{Numri i procedurave me një ofertë të vetme} / \text{Totali i procedurave të dhëna}) \times 100$	E ulët ($\leq 5\%$), E moderuar (5–20%), E lartë ($\geq 20\%$)	Vjetore
5	Kohëzgjatja e periudhës së vendimmarrjes	Numri i ditëve midis afatit të dorëzimit dhe datës së vendimit për dhënien e procedurës së prokurimit	E ulët (10–30 ditë), e moderuar (> 30 ditë ose < 5 ditë), e lartë (> 60 ditë)	Çdo vit/për procedurë specifike
6	Pjesa e kontratave të dhëna të njëjtit OE, numri	$(\text{Kontratat e dhëna furnizuesit kryesor} / \text{Totali i kontratave}) \times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore
7	Pjesa e vlerës totale të kontratave të dhëna të njëjtit OE	$(\text{Vlera totale e kontratave të dhëna furnizuesit kryesor} / \text{Vlera totale e kontratave të prokuruar}) \times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore
8	Vonesa në zbatimin e kontratës	$(\text{Kontrata me vonesa} / \text{Totali i kontratave të ekzekutuara}) \times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore
9	Raporti i Tejkalimit të Kostos (RTK)	$((\text{Vlera përfundimtare e kontratës} - \text{Vlera fillestare}) / \text{Vlera fillestare}) \times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Çdo vit/për procedurë specifike
10	Zgjatja e zbatimit të kontratës	$(\text{Kontratat e zgjatura pa procedurë konkurruese} / \text{Totali i kontratave të ekzekutuara}) \times 100$	E ulët ($\leq 10\%$), E moderuar (10–40%), E lartë ($\geq 40\%$)	Vjetore

10.B.2 Analiza e Riskut

Analiza e riskut përfshin vlerësimin e gjasave dhe ndikimit të mundshëm të risqeve të korrupsionit të identifikuar në nivel mikro.

Përveç treguesve të identifikuar më sipër, analiza e riskut në nivel mikro mund të përfshijë edhe monitorimin ex-post të procedurave të prokurimit nga APP-ja, si dhe auditimin e procedurave nga Kontrolli i Lartë I Shtetit ose institucione të tjera auditimi.

Pyetësorët e përfshirë në shtojcën e këtij dokumenti mund të përdoren gjithashtu për këtë vlerësim.

Siç është përcaktuar tashmë në seksionin më sipër, secilit tregues do t'i caktohet një pikëzim, duke përcaktuar nivelin e përgjithshëm të riskut për secilin prej tyre dhe duke përcaktuar flamujt e kuq.

Niveli i riskut duhet të vizualizohet në një skemë ngjyrash si më poshtë.

- “I ulët” → Jeshile
- “I moderuar” → E verdhë
- “I lartë” → E kuqe

Këtu do të përdoret e njëjta formulë si në vlerësimin e riskut në nivel makro.

Nëse për çdo nivel të matur, për secilin tregues, rezultati i Ulët caktohet 1 pikë; i Mesëm - 2; dhe i Lartë - 3, me numrin total të treguesve që është 10, tabela më poshtë mund të tregojë situatën e përgjithshme:

Treguesi	Nivel i ulët X ≤ 10	Nivel i moderuar 10 < X ≤ 20	Nivel i lartë 20 < X ≤ 30	X = Numri i pikëve totale për të gjithë treguesit
1	1	2	3	
2	1	2	3	
3	1	2	3	
4	1	2	3	
5	1	2	3	
6	1	2	3	
7	1	2	3	
8	1	2	3	
9	1	2	3	
10	1	2	3	
Totali	10	20	30	X

Në varësi të vlerës së pikëve për secilin tregues, rezultati total mund të jetë një kombinim i tre kolonave. Sa më i lartë të jetë rezultati, aq më i lartë është edhe risku i korrupsionit.

Për shembull,

Treguesi	Nivel i ulët risku $X \leq 10$	Nivel moderuar risku $10 < X \leq 20$	Nivel i lartë risku $20 < X \leq 30$	X = Numri i pikëve totale për të gjithë treguesit
1	1			1
2		2		2
3	1			1
4		2		2
5	1			1
6		2		2
7	1			1
8	1			1
9	1			1
10		2		2
Totali	6	8	0	14

Rezultati total në këtë rast është $6 + 8 + 0 = 14$ pikë, pra $X = 14$, duke e klasifikuar në nivelin e dytë, nivel i moderuar risku.

Vlerësimi i riskut të korrupsionit mund të bëhet edhe vetëm për një procedurë prokurimi. Pyetësi gjithashtu mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë risqet.

Përmes këtij vlerësimi dhe duke përdorur edhe pyetësit, APP-ja mund të identifikojë masat që duhen ndërmarrë, për të ulur më tej vlerën e treguesve.

10.B.3 Masat e zvogëlimit të Riskut

Këto masa janë hartuar për të zvogëluar mundësinë ose ndikimin e risqeve të korrupsionit të identifikuar.

Në varësi të nivelit të riskut të identifikuar për secilin prej treguesve të mësipërm, autoriteti kontraktor mund të marrë në konsideratë masat e mëposhtme:

- Forcimi i proceseve të planifikimit dhe harmonizimi me ciklet e buxhetit në mënyrë që të shmangen vonesat në publikim.
- Planifikimi herët për të zvogëluar prokurimet emergjente; zbatim i kontrolleve të justifikimit.
- Të përmirësohet analiza e tregut dhe përgatitja e specifikimeve të tenderit me qëllim shmangien sa më shumë të jetë e mundur të rishpalljeve të procedurave.
- Rritja e publikimit të procedurave të prokurimit dhe shqyrtimi i specifikimeve për konkurrueshmëri.
- Të qarkullohen furnizuesit aty ku është e mundur dhe të rishikohet historiku i dhënieve të kontratave.
- Të përmirësohet monitorimi i zbatimit të kontratës dhe të përfshihen klauzolat e penalizimit.
- Sigurimi i dokumentacionit dhe justifikimi i duhur për zgjatjet e kontratave.

Gjithashtu, mund të rekomandohet trajnimi i punonjësve të përfshirë në procesin e prokurimit.

Vlerësimi i riskut të korrupsionit në nivel mikro rekomandohet për autoritetet kontraktore. Ata mund ta kryejnë një vlerësim të tillë shpesh për procedurat e prokurimit brenda AK-së së tyre, por të paktën një herë në vit. Mars - Prill rekomandohet që AK-të të përfundojnë një vlerësim të tillë, në mënyrë që APP-ja të përdorë të dhënat për vlerësimin e riskut të bërë nga ky i fundit.

AK-të mund të përdorin gjithashtu pyetësoin (shtojca 1) ose të dhënat e vlerësimit të riskut në nivel makro për t'u orientuar më mirë.

APP-ja mund të rekomandojë ose t'u kërkojë AK-ve të kryejnë një vlerësim të tillë sa herë që është e nevojshme.

SHTOJCA 1 – Pyetësor

Kjo është një listë treguese pyetjesh. Në varësi të fokusit, disa nga pyetjet mund të hiqen nëse nuk janë relevante për situatën.

Pyetësori mbi

Vlerësimi i Riskut të Korrupsionit në Prokurimin Publik

1. Lloji i organizatës suaj:

Organ Qendror

Qeverisja Vendore

Tjetër (ju lutem specifikoni) _____

2. Roli juaj në prokurimin publik brenda organizatës suaj

Zyrtar i Prokurimit

Njësia e Prokurimit

Komisioni i Vlerësimit

Faza e planifikimit

Hartimi i Specifikimeve Teknike

Faza e ekzekutimit të kontratës

3. A keni ndjerë presion nga eprorët tuaj gjatë procesit të prokurimit?

PO

JO

DISI

4. Sektori ku përqendrohen shpenzimet tuaja:

Ndërtim

Shëndetësi

Tjetër (ju lutem specifikoni) _____

5. Numri total i procedurave të prokurimit gjatë kësaj periudhe:

Numri _____

6. Vlera totale e procedurave të prokurimit gjatë kësaj periudhe:

Vlera _____

7. Numri total i procedurave të prokurimit që nuk u përfunduan brenda afatit të planifikuar në regjistrin e parashikimeve:

Numri _____

8. Numri i procedurave ku përdoren kriteret MEAT (Oferta Ekonomikisht Më e Favorshme) bazuar në kosto:

Numri i llogaritur në % _____

9. Numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës:

Numri i llogaritur në % _____

10. Vlera e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës:

Vlera e llogaritur në % _____

11. Arsyet për kryerjen e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës:

Neni 47 pika 1/a

Neni 47 pika 1/b/i

Neni 47 pika 1/b/ii

Neni 47 pika 1/b/iii

Neni 47 pika 1/c

Neni 47 pika 2/a

Neni 47 pika 2/b

Neni 47 pika 2/c

Neni 47 pika 2/ç

Neni 47 pika 3

Neni 47 pika 4

12. Numri total i ofertuesve në të gjitha procedurat e prokurimit:

Numri _____

13. Numri total i ofertuesve të kualifikuar në të gjitha procedurat e prokurimit:

Numri i llogaritur në % _____

14. Numri total i ofertuesve të skualifikuar në të gjitha procedurat e prokurimit:

Numri i llogaritur në % _____

15. Numri i procedurave me një ofertues të vetëm:

Numri i llogaritur në % _____

16. Vlera totale e procedurave me një ofertues të vetëm:

Vlera e llogaritur në % _____

17. Ju lutemi specifikoni arsyet për pjesëmarrjen e ulët të ofertuesve sipas analizës/mendimit tuaj:

Vlera e parashikuar e kontratës (vlerë e ulët dhe pa interes) _____

Kriteret e kualifikimit/ _____ specifikimet teknike (SBD)(konkurrencë e kufizuar për shkak të tyre)

Legjislacioni sektorial (licencat/lejet etj. që kufizojnë konkurrencën)

Specifikat e tregut (tregu për produkte/shërbime/puna të tilla është i kufizuar)

18. Numri i procedurave ku fituesi është i njëjtë me vitin/kontratën e kaluar?

Numri i llogaritur në % _____

19. Vlera totale e procedurave ku fituesi është i njëjtë me vitin/kontratën e kaluar?

Vlera e llogaritur në % _____

20. Numri i procedurave ku oferta me vlerën më të ulët skualifikohet:

Numri i llogaritur në % _____

21. Vlera totale e procedurave ku oferta me vlerën më të ulët skualifikohet:

Vlera e llogaritur në % _____

22. Numri i procedurave të anuluar (nëse procedura anulohet më shumë se një herë, ju lutemi numëroni secilën):

Numri i llogaritur në % _____

23. Vlera totale e procedurave të anuluar (nëse procedura anulohet më shumë se një herë, ju lutemi llogaritni vlerën për secilën):

Vlera e llogaritur në % _____

24. Ju lutemi specifikoni arsyet për procedurat e anuluar:

- në procedurat me faza, nuk është paraqitur asnjë ofertë përkatëse
- në procedurat me një fazë nuk u paraqit asnjë ofertë përkatëse
- konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të konsiderueshme.
- për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit/entit kontraktor kanë ndryshuar;
- kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas dispozitave në LPP;
- kur Titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas dispozitave në nenin 19/4 të LPP-së.

25. Gjatë zbatimit të kontratës, sa kontrata ndryshohen?

Numri total i kontratave të ndryshuara të llogaritura në % _____

26. Gjatë zbatimit të kontratës, cila është vlera e kontratave të ndryshuara (ju lutem nëse një kontratë ndryshohet disa herë, vlera llogaritet vetëm një herë)?

Vlera e llogaritur në % _____

27. Sa herë ndryshohen afatet e dorëzimit (dorëzimi përfundimtar dhe ato ndërmjetëse)?

Numri i llogaritur në % _____

28. Sa herë ndryshohet vlera totale e kontratës?

Numri i llogaritur në % _____

29. Në rastin e procedurave të ndërtimit, gjatë fazës së zbatimit; sa herë mbikëqyrësi (përfshirë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë, ose vetëm një nga OE) dhe kontraktori (përfshirë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë, ose vetëm një nga OE) janë të njëjtë në kontrata të ndryshme:

Numri i llogaritur në % _____

Vlera Totale e Kontratave të Mbikëqyrura e llogaritur në % _____

30. Numri i ankesave që lidhen me vlerën e parashikuar të kontratës:

Numri i llogaritur në % _____

31. Numri i ankesave që lidhen me specifikimet teknike:

Numri i llogaritur në % _____

32. Numri i ankesave që lidhen me kriteret e kualifikimit:

Numri i llogaritur në % _____

33. Numri i ankesave që lidhen me kriteret e vlerësimit:

Numri i llogaritur në % _____

34. Numri i procedurave ku modifikohen Dokumentet e Tenderit:

Numri i llogaritur në % _____

35. Numri i procedurave ku modifikohen Dokumentet e Tenderit dhe zgjatet afati për dorëzimin e ofertës:

Numri i llogaritur në % _____

36. Numri i ankesave që lidhen me fazën e kualifikimit:

Numri i llogaritur në % _____

37. Numri i procedurave ku afati për përfundimin e të gjithë procedurës është zgjatur përtej afateve ligjore:

Numri i llogaritur në % _____

38. Arsyet pse procedurat kanë zgjatur afatin për përfundimin e të gjithë procedurës përtej afateve ligjore (ju lutemi jepni numrin e procedurave në %):

Modifikimi i dokumenteve të tenderit _____

Ankesat për dokumentet e tenderit _____

Zgjatja e afateve të vlerësimit _____

Ankesat për procesin e vlerësimit _____